



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 1034 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 02 . 09 .2010

Lënda: Dërgohet "Raporti i punës për muajin Gusht 2010"

Drejtuar: **Z. BUJAR NISHANI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po Ju paraqesim Raportin mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Gusht 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konceptoi: Saimir Shyti
Datë 02.09.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN GUSHT 2010

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Gusht 2010.

I. Statistika

Për periudhën 01-31 Gusht 2010, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 31 Gusht 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën 01.06.2009 - 31.08.2010, është 1979 të dënuar.

Nga 01.06.2009 deri më datë 31.08.2010, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **87** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është 1892 të dënuar.

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **865** të dënuar me dënime alternative.

Sjithë?

Përfundim

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **346** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **341** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **340** të dënuar me dënime alternative.
- 2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.**

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **1892** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **63**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **87** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **49** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **49** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **57** të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, gjatë muajit Gusht 2010 kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes **12** të dënuar. Shtesa për muajin Gusht 2010 (nga 01.08.2010 - 31.08.2010), prej **55** të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 31.08.2010**, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyruar nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

